



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec




PROCESVERBAL

Nga mbledhja **INAUGURUESE** e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **08.12.2025**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi anëtari më i moshuar i kuvendit komunal, **z. Sali Sallteku**. Kryesuesi konstatoi se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë të zgjedhur, të pranishëm kanë qenë 27.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, klerikë fetarë, drejtorë, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje INAUGURUESE për legjislaturën 2025-2029, kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE



1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
2. Dhënia e betimit nga Kryetari i Komunës;
3. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;
4. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
5. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës:

Kryesuesi: Fillimisht, më duhet ta verifikoj listën e kandidatëve që janë prezentë dhe në momentin që ju thërras emrin, të gjithë kandidatët duhet të deklarohen me ngritje të dorës. Me regjistrimin e ri të popullësisë, kuvendi i komunës së Rahovecit siç e dini tani i ka 27 anëtarë.

Skender Hamza: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Përshëndetje kryesues, anëtarëve të rinj ju uroj sukses. Besoj që do të kryeni një punë mjaft të mirë për komunën e Rahovecit. Ata që i thërras, ju lutem ngriteni dorën: Fatmir Iska, Besnik Hoti, Mentor Durguti, Feriz Thaqi, Ruzhdi Morina, Saranda Sallteku, Berat Duraku, Lendrit Morina, Nora Boshnjaku, Dafina Gashi, Enis Durguti, Lirigzon Kastrati, Nehar Shala, Qazim Cana, Faharije Lushi – Morina, Yllka Shehu, Hazbije Shala, Vlora Vuçiterna – Çmega, Zana Qanta, Defrim Kafexhiu, Bujar Mustafa, Jusuf Dërmala, Sali Sallteku, Melinda Iska, Altin Zhuniqi, Mirsad Shehu, Flutura Thaqi.

Kryesuesi: Faleminderit! U verifikua se të gjithë anëtarët e kuvendit janë të pranishëm. Tani, ftoj anëtarët e kuvendit që të bëjnë dhe ta nëshkruajnë betimin! Të ngriten në këmbë dhe të bëjnë betimin duke lexuar deklaratën solemne, duke e përsëritur fjalë për fjalë deklaratën. Unë, Sali Sallteku, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Urime! Tani e ftoj kryetarin e komunës, z. Smajl Latifin që ta bëjë betimin.

2. Dhënia e betimit nga Kryetari i Komunës:

Unë, Smajl Latifi, betohem që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si kryetar i Komunës së Rahovecit me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe ne pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushtet për jetë të qetë për të gjithë, betohem!

3. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës:

Kryetari: Të dashur familjarë të dëshmorëve, veteranë e invalidë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare, përfaqësues të të gjitha institucioneve e të organeve komunale, përfaqësues nga policia, komandant i stacionit, kapiten Morina, udhëheqës të bashkësive fetare, të shoqërisë civile, të medie, të dashur bashkëpunëtorë dhe miq, të dashur familjarë të mi, baba, xhaxhallarë, bashkëshorte e imja, fëmijë të mi, Etnik e Adea, Leonita, familjarë të tjerë, mysafirë e të ftuar. Të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Komunal, që porsa u betuat, i nderuar i kësaj seance, Sali Sallteku, të dashur pjesëmarrës! Këtu e kemi kryetarin e PDK-së z. Edon Cana. Sot, qëndroj para jush me ndjenjën më të thellë të nderit dhe të përgjegjësisë. Sot e vazhdoj mandatin tim si Kryetar i Komunës së Rahovecit, për të tretën herë radhazi, të katërtën në këtë udhëtim të përbashkët. Ky është besim i madh që një njeri mund ta marrë nga populli i tij. Ky është vlerësimi më i lartë që qytetari ia bën punës, përkushtimit dhe fjalës së mbajtur dhe unë këtë besim nuk e marr si privilegj, por si detyrim. Në këto vite kemi kaluar shumë rrugë bashkë. Kemi ndërtuar, kemi përballuar sfida, kemi marrë vendime të vështira, kemi punuar ditë pas dite për ta çuar Rahovecin përpara. E kemi bërë me qetësi e me përkushtim, me vendosmëri e me guxim, me përgjegjësi e me besim, të bindur se vendi ynë asnjëherë nuk kishte e as nuk ka kohë për të humbur. Mandati që fillon sot është forcim i zotimit tim, një zotim i qartë se komuna e Rahovecit do të ecë drejt standardit, drejt përparimit dhe drejt një të ardhmeje që e ndërtojmë me punë të përditshme. Unë betohem si një njeri që ka parë, që ka mësuar, që di peshën e përgjegjësisë dhe e kupton thelbësisht ritmin që kërkon zhvillimi. Ky mandat është shenjë e qartë besimi, por është edhe thirrje për të mos u mjaftuar asnjëherë me atë që është bërë deri tani. Është thirrje për të çuar punët tutje, për të kërkuar më shumë nga vetja, për të kërkuar më shumë prej të gjithëve që mbajnë përgjegjësi publike. Sepse Rahoveci nuk ngrihet me fjalë. Rahoveci ngrihet dhe ecë pandalshëm vetëm me punë, me disiplinë dhe me vendimmarrje të drejtë. Të nderuar qytetarë, do të jem përherë kryetari: Që udhëheq me ndershmëri, që mbrojt interesin public, që ruan dinjitetin e institucionit, që është i drejtë dhe i barabartë me secilin e secilën, që qëndron dinjitoz dhe i gatshëm për të ushtruar përgjegjësitë dhe vepron për interesin e madh publik e qytetar, që është krah jush në çdo sfidë që prek jetën e komunës sonë. Unë e di sa shumë kërkon kjo detyrë. E di sa shumë vështirësi ka, e di sa shumë sytë e njerëzve janë të drejtuar kah kryetari i tyre, për drejtësi, për përgjigje, për zgjidhje. Dhe ju them sot, me bindje të plotë: Unë do të jem aty, siç kam qenë dhe siç duhet të jem. Të dashur qytetarë, ky mandat është prova e katërt e besimit tuaj dhe është edhe përgjegjësia ime më e madhe, të mos lejoj asnjë hap pas, të mos humbas asnjë ditë pa punë, të mos kursej asnjë energji për të mirën e komunës së Rahovecit. Puna jonë ka qenë e vështirë, por e drejtë. Rruga jonë ka qenë sfiduese, por e qëndrueshme. Besimi juaj e ka bërë të mundur që sot të nis një tjetër kapitull: më i fortë, më i qëndrueshëm, më i vendosur. Qytetarë të dashur, unë betohem sot përpara jush, përpara kësaj komune dhe para ndërgjegjes sime: Do të udhëheq me vendosmëri. Do t'i shërbej Rahovecit me të gjithë forcën, me përvojën dhe me dijen që kam. Do të punoj me ritmin që kërkon koha dhe me përgjegjësinë që kërkon besimi juaj. Rahoveci është shtëpia jonë, është nderi ynë, është obligimi ynë i përbashkët, ndaj nuk do të ndalemi. As sot, as nesër, asnjë ditë të këtij mandati. Ju faleminderit nga zemra për besimin! Me ju e për ju, puna nuk ndalet!

Kryesuesi: Urime kryetar! Vazhdojmë me një pauzë prej 15 minutave.

4. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës:

Sali Sallteku: Lidhur me këtë pikë e njoftoj kuvendin se, për zgjedhjen e kryesuesit janë të parapara disa procedura: Konform udhëzimit administrativ Nr.2009/01, udhëzimit administrativ për procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës: Në nenin 2, pika 2: Secili subjekt politik, nismë qytetare apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvendin e komunës, ka të drejtë që në radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës të propozoj një anëtar për kryesues të kuvendit. Pika 3 - Kuvendi i komunës, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve, formon komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë. Pika 4 - Komisioni për votim është përgjegjës që t'i numërojë votat dhe të komunikojë për rezultatet e votimit, para anëtarëve të kuvendit. A jeni për 3 apo 5 anëtarë

që t'i ketë komisioni?... Kush është për 3 anëtarë?... Pra, është vendosur që komisioni t'i ketë 3 anëtarë. Shkojmë me propozime për anëtarë të komisionit, për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Nora Boshnjaku: Përshëndetje, nga radhët e AAK-së, propozojmë Feriz Thaqin.

Lirigzon Kastrati: Përshëndetje, nga radhët e LDK-së, propozojmë dr. Qazim Canën.

Vlora Vuçitërna Çmega: Përshëndetje, meqenëse komisioni përbëhet prej 3 anëtarëve, LVV nuk ka propozim.

Mirsad Shehu: Përshëndetje, nga radhët e PDK-së, propozojmë Melinda Iskën.

Kryesuesi: Ju falënderoj! E vendosim në votim këtë propozim për komisionin e mbarëvajtjes së procesit të votimit. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota “për” propozimi kalon. Anëtarët e komisionit i lus që të ulen në vendin e tyre. Vazhdojmë... Pika 1 - Votimi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës bëhet me votën e fshehtë. Pika 2 - Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati i propozuar për kryesues të kuvendit të komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit. Pika 3 - Nëse pas votimit të parë, asnjëri prej kandidatëve të propozuar për kryesues të kuvendit të komunës nuk merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, atëherë dy kandidatët të cilët kanë fituar numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës në rundin e dytë, zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës. Pika 4 - Nëse edhe pas votimit të dytë, asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij udhëzimi administrativ, atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë, kryesuesi i kuvendit të komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të përhershëm dhe që votojnë në propozimin në mbledhjen e kuvendit të komunës. Pika 5 - Nëse edhe në votimin e tretë nuk zgjidhet kryesuesi i kuvendit të komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës përsëritet dhe fillon prapë nga e para. Të nderuar anëtarë të kuvendit, kërkoj nga grupet politike që të japin emrat e kandidatëve për kryesues të kuvendit.

Nora Boshnjaku AAK: I nderuar kryetar i Komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi, i nderuar udhëheqës i seancës inauguruese z. Sali Sallteku, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal të Rahovecit, shumë të respektuar familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të institucioneve, qytetarë, medie dhe ju të pranishëm. Sot jemi mbledhur për të shënuar një hap të rëndësishëm institucional, një moment që përcakton drejtimin dhe frymën e punës së kuvendit tonë për katër vitet e ardhshme. Në këtë frymë bashkëpunimi, përgjegjësie dhe transparence, nga radhët e AAK-së kam nderin që të propozoj z. Fatmir Iska për kryesues të kuvendit komunal të Rahovecit. Tani po e lexoj një biografi të shkurtër: Fatmir Iska është një kuadër me mbi 25 vite përvojë në institucione publike, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat. Përgjatë gjithë karrierës së tij, ai është dëshmuar si profesionist i përkushtuar, me integritet të lartë dhe me njohuri të thella për funksionimin e institucioneve lokale. Karrierën e ka nisur në misionin e OSBE-së si Mbikëqyrës për Siguri, përvojë e cila i ka ndërtuar bazat e forta në menaxhim, përgjegjësi institucionale dhe bashkëpunim ndërinstitucional. Më pas ka punuar në Raiffeisen Bank dhe si Menaxher në Elkos në Rahovec, duke dëshmuar aftësi profesionale edhe në sektorin privat. Nga viti 2011 deri më 2013 ka shërbyer si Drejtor i Drejtorisë për Kadastrë, Gjeodezi dhe Pronë, ku është vlerësuar për qasjen efikase dhe vendimmarrjen e përgjegjshme. Në periudhën 2013-2017 ka ushtruar detyrën e asambleistit të Komunës së Rahovecit, duke krijuar reputacion të lartë si njohës i punës së kuvendit, procedurave, komisioneve dhe funksionimit të organeve të tij. Përvoja e gjatë në Kuvend e ka bërë atë një figurë të çmuar, të aftë për të kontribuar me profesionalizëm, maturi dhe vizion. Ai njihet për komunikim të hapur, kulturë institucionale dhe qasje unifikuese, që e karakterizojnë në secilën detyrë. Ai ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Me respekt dhe besim të plotë institucional propozoj që z. Fatmir Iska të merr përgjegjësinë e kryesuesit të kuvendit komunal të Rahovecit, për mandatin në vijim. Ju falënderoj për vëmendje dhe ju uroj punë të mbarë në vazhdimin e seancës.

Lirigzon Kastrati LDK: Faleminderit, i nderuar udhëheqës i seancës inauguruese. Të dashur qytetarë qytetarë të komunës së Rahovecit, i nderuar kryetar, kolegë anëtarë të kuvendit komunal. Sot nis mandati i ri i kuvendit

komunal të Rahovecit dhe secili prej nesh ka përgjegjësi që të punojë me ndershmëri dhe transparencë në shërbim të qytetarëve që na kanë votuar. LDK-ja si forca më e madhe opozitare në këtë kuvend, hyn në këtë mandat me qasje konstruktive dhe të vendosur. Ne do të mbështesim secilën iniciativë që është në të mirë të komunës dhe do të kundërshtojmë çdo veprim që bie ndesh me parimet e qeverisjes së mirë. Sot, në zgjedhjen e kryesuesit e kemi një pyetje për propozuesen e kryesuesit se, a i keni numrat për zgjedhjen e kryesuesit? E them këtë me mesazh të qartë, që kuvendi duhet të udhëhiqet me paanshmëri dhe me respekt të barabartë për të gjitha grupet politike, si dhe me përgjegjësi të plotë ndaj qytetarëve. LDK, do të vazhdojë të jetë zë i fuqishëm i opozitës së përgjegjësi duke mbrojtur interesin publik, buxhetin e komunës dhe projektet që ndikojnë në jetën e qytetarëve të komunës sonë. Ne jemi këtu për të punuar, për të propozuar dhe për të kërkuar llogari. Uroj që ky mandat të jetë mandat i bashkëpunimit dhe vendimeve të drejta për komunën e Rahovecit. Ju faleminderit dhe suksese për të gjithë. Nuk kemi propozim.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit kryesues i seancës inauguruese. I nderuar kryetari i Komunës së Rahovecit, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit komunal që sapo u betuam për mandatin e ri. Proceset demokratike, sikur zgjedhjet dhe tranzicioni prej një mandati në tjetrin, janë vlerësim që duhet të përshëndetet, sepse është nga qytetarët të cilët jetojnë të lirë, për lirinë që shumë breza kanë luftuar. Më lejoni që t'i përshëndes veprimtarët e qështjes kombëtare: luftëtarët e UÇK-së, veteranët, komandatin e stacionit policor, ish drejtorë e ish kandidatë për asamble, qytetarë të komunës së Rahovecit. Sot, po jetësojmë një proces demokratik dhe jemi duke i zgjedhur institucionet që i shërbejnë qytetarëve direkt me politikën që i bëjmë dhe vendimet që i marrim. Si grup i LVV-së në kuvendin komunal të Rahovecit, përfaqësohemi me 5 anëtarë të kuvendit, bashkë me të cilët do të veprojmë në interesin e qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe do ta përshëndesim çdo projekt që është në të mirën e tyre, si dhe do të kundërshtojmë çdo vendim që është në dëm të tyre. Për këtë pikë të rendit të ditës, në emër të grupit të LVV-së do t'i jap arsyet që vota jonë është kundër propozimit të grupit më të madh politik në kuvend. Në mungesën e shumicës që sipas vullnetit të qytetarëve nuk e keni në kuvendin komunal, është një përbashkim i pasinqertë në mes frymave kundërshtuese dhe një përbashkim jo i natyrshëm për të udhëhequr me Komunën e Rahovecit. Me gjithë respektin që e kemi për të propozuarin për kryesues, ne e kundërshtojmë për shkak të arsyeve më lartë dhe nuk mendojmë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, nëse do të kishte një propozim dhe një përbashkim opozitar, ne do ta mbështetnim një të propozuar të opozitës dhe meqenëse nuk është, LVV nuk ka propozim.

Kryesuesi: Faleminderit shumë! Kërkoj një pauzë prej 5 min. derisa Sekretaria e Kuvendit t'i përgatit listat me emrat e kandidatëve të propozuar për kryesues të kuvendit... Atëherë, ftoj komisionin që të verifikojë se a janë 27 fletvotime. Pas konstatimit të komisionit se gjithçka është në rregull, fillojmë me votimin për kryesues të kuvendit dhe e ftoj sekretarinë e kuvendit që t'i thërret delegatët një nga një. Mënyra e votimit bëhet duke shënjuar një shenjë në katrorin e vogël para kandidatit.

Feriz Thaqi: Përshëndetje për të gjithë! Fletëvotimet i numruam, janë 27 fletëvotime.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë vazhdojmë: Fatmir Iska, Besnik Hoti, Mentor Durguti, Feriz Thaqi, Ruzhdi Morina, Saranda Sallteku, Berat Duraku, Lendrit Morina, Nora Boshnjaku, Dafina Gashi, Enis Durguti, Lirigzon Kastrati, Nehar Shala, Qazim Cana, Faharije Lushi – Morina, Yllka Shehu, Hazbije Shala, Vlora Vuçiterna – Çmega, Zana Qanta, Defrim Kafexhiu, Bujar Mustafa, Jusuf Dërmala, Sali Sallteku, Melinda Iska, Altin Zhuniqi, Mirsad Shehu, Flutura Thaqi... Tani, ftoj komisionin që t'i numëroj votat. Pas përfundimit të numërimit, kryetari i komisionit konstaton se kanë votuar 27 anëtarë dhe prej tyre me 15 vota "për" 7 abstenime dhe 5 vota kundër. Konstatojmë se, kryesues i ri i Kuvendit Komunal është z. Fatmir Iska, të cilin e ftojmë që të ulet në ulësen e kryesuesit të kuvendit të komunës, për ta vazhduar udhëheqjen e seancës. Urime Fatmir, e gëzofsh!

Fatmir Iska (kryesuesi): I nderuar kryetar i komunës, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të partive politike, të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë, veteranë, zonja dhe zotërinj. Është nder dhe përgjegjësi për mua, që sot marr detyrën e kryesuesit të kuvendit komunal të Rahovecit. Ky besim që ma keni

dhënë është një obligim që e pranoj me përkushtim të plotë dhe me bindjen që së bashku do të punojmë për të mirën e komunës së Rahovecit. Rahovecit është komunë me traditë, me histori pune dhe përkushtimi, me njerëz të ndershëm, punëtorë e vizionarë dhe prandaj angazhimi ynë duhet të jetë shembull i transparencës, bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë. Ne mund të kemi qëndrime të ndryshme politike, por synimi i përbashkët duhet të jetë i qartë: përparimi dhe mirëqenia e qytetarëve. Do të angazhohem që puna e kuvendit të zhvillohet me efikasitet, duke garantuar hapësirë të barabartë për të gjitha grupet politike dhe duke dëgjuar zërin e secilit anëtar, si dhe duke siguruar që vendimet tona janë të bazuara në ligj, kompetencë dhe interes publik. Ju falënderoj për besimin dhe pres që të kemi bashkëpunim me secilin prej jush. Zoti e bekoftë Rahovecin! Faleminderit!... Atëherë, të nderuar kuvendarë, me kaq po e mbyllim këtë seancë dhe shihemi në seancat e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I



Fatmir Iska